



Asociacioni i Komunave të Kosovës

RAPORT

nga

Takimi i Kolegjiut për Planifikim Hapësinor

Gjakovë, 18 maj 2011

Për: Ertan Munoglu – Menaxher i Programit i AKK-së

Nga: Fisnik Dashi – Koordinator i Kolegjiumeve të AKK-së

Lënda: Raport nga takimi i Kolegjiut për Planifikim Hapësinor



HYRJE

Asociacioni Komunave të Kosovës (AKK) në bashkëpunim me Kryesinë e Kolegjiut për Planifikim Hapësinor organizoi takimin e parë për këtë vit të këtij Kolegjiut me 18 maj 2011 (e mërkurë) me fillim nga ora 11:00 në Hotel 'Jakova' në Gjakovë.

Takimi kishte për qëllim të diskutohej rendi i ditës i përcaktuar më parë nga Kryesia me këto pika:

- Plotësimi i Kryesisë së Kolegjiut
- Miratimi i Rregullores së Punës dhe Planit të Punës për vitin 2011
- Pjesëmarrje në Grupin Punues për Ligjet relevante
- Identifikimi i nevojave për trajnim dhe shkëmbim të përvojave mes Komunave të Kosovës
- Analizë e organizimit të Drejtorive të Urbanizmit/Planifikimit Hapësinor/Mbrojtje të Mjedisit (nr i stafit dhe kualifikimi, emërtimi, organizimi i brendshëm, konflikt mandati për planifikim/lëshim të lejeve),

Në këtë takim morën pjesë Drejtorë të Urbanizmit nga Komunitet e Kosovës, si dhe përfaqësues të AKK-së. Takimi u kryesua nga Kryesuesja e Kolegjiut për Planifikim Hapësinor znj. Qazime Vata.

PËRMBLEDHJE

znj. Qazime Vata, Kryesuese e Kolegjiut – në fjalën hyrëse përshëndeti të pranishmit e këtij takimi, njëkohësisht shprehu edhe shqetësimin e saj në pjesëmarrjen e dobët të drejtorëve komunal, duke marrë parasysh se është takimi i parë i këtij viti ku do të duhej të diskutohej dhe miratohet plani i punës për këtë vit.

➤ **Plotësimi i Kryesisë së Kolegjiut**

Kryesuesja – sqaroi se duke marrë parasysh largimin e zv. Kryesuesit nga posti i tij, ky vend në Kryesinë e Kolegjiut është i lirë në dhe kërkon të plotësohet.

Pas propozimit dhe diskutimit, pa asnjë kundërshtim u miratua vendimi që znj. Leonora Rraci, Drejtoreshë për urbanizëm dhe planifikim në Komunitetin e Gjakovës, të jetë zv. Kryesuesja e re e Kolegjiut.

➤ **Miratimi i Rregullores së Punës dhe Planit të Punës për vitin 2011**

Kryesuesja – propozoi që të ndryshojë rregullorja sa i përket numrit të kryesisë në 7 anëtarë dhe ata të jenë përfaqësuesit nga: Ferizaji, Gjakova, Prishtina, Ranillugu, Mitrovica, Prizreni dhe Vitia. Rregullorja u miratua në parim me sugjerimin se duke marrë parasysh se takimet nuk janë mbajtur me kohë, të ndryshohet pika 2.5 dhe të përshkruhet se takimet do të mbahen sipas vullnetit dhe nevojave të Kolegjiut.

z. Hazir Zhitija, koordinator për legalizim, Prishtinë - ceku se do të ishte mirë të përfshihet në agjendë edhe plotësimi ndryshimi i ligjit për planifikim hapësinor, dhe të dilet me një rekomandim konkret.

Kryesuesja – njoftoj se do të jetë vështirë në ndryshimin e strategjisë legjislative qeveritare, mirëpo do të rishikojmë dhe bëjmë përpjekje nëse do të kemi mundësi për një gjë të tillë.

znj. Rraci – theksoj është me rëndësi të veçantë miratimi i planit të punës për shkakun e ecurisë së punës, andaj duhet të veprojmë sa më shpejt. Problematike mbetet përmbajtja e planeve rregulluese, dhe prandaj është mirë që së bashku me AKK-në dhe në koordinim me Ministrinë të ndryshohet kjo me një udhëzim administrative të ri.

z. Zhitija – ne kemi probleme me planet rregulluese të zhvillimit, andaj është i domosdoshëm ndryshimi i ligjit të planifikimit hapësinor apo strukturave të veçanta të tij.

Kryesuesja- sugjeroj që të ndryshojë pika 1.2.2 në ndryshim dhe plotësim të udhëzimeve administrative për implementimin e planeve rregullative, ku me këto ndryshime edhe u miratua plani plan i punës për vitin 2011.

➤ **Pjesëmarrje në Grupin Punues për Ligjet relevante (Ligji për kadastër dhe ai për ndërtim)**

Kryesuesja - kemi pasur takim me zyrtarët ligjor të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive ku është diskutuar pjesëmarrja në grupet punuese në procesin legjislativ. Është kërkuar të japim kontributin tonë në këto grupe dhe me këtë rast edhe duhet të bëjmë identifikimin e personave të përshtatshëm të cilët do të marrin pjesë në këto grupe punuese legjislative.

Pas debatit u vendos që në grupet punuese të jenë këta përfaqësues nga Kolegjiumi:

- z. Blerim Beshtica - zyrtar ligjor në Drejtorinë për Kadastër, Gjeodezi, Pronë dhe Banim në Gjilan - si përfaqësues në grupin punues për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.2003/25 për Kadastër, dhe

- znj. Leonora Rraci - Drejtoreshë për urbanizëm dhe planifikim në Gjakovë - si përfaqësuese në grupin punues për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.2004/15 për Ndërtimet.

➤ **Identifikimi i nevojave për trajnim dhe shkëmbim të përvojave mes Komunave të Kosovës**

znj. Rraci - është mirë të kemi trajnime në GIS sipas nevojave të paraqitura nga drejtoritë e urbanizmit.

z. Zhitija – kemi nevojë për trajnime rreth planifikimit hapësinor nga njerëz profesionist në këto lëmi, sepse në të kaluarën kemi pasur disa ligjërues të cilët nuk kanë qenë profesionalisht adekuat për këto ligjërime.

z. Mehdi Salihu, Drejtor për urbanizëm dhe planifikim, Shtime - duhet të konsiderojmë edhe shkëmbimin e përvojave nga vendet e rajonit, nëse do të ishte e mundshme që në bashkëpunim me AKK-në të organizohen edhe këto takime.

➤ **Analizë e organizimit të Drejtorive të Urbanizmit/Planifikimit Hapësinor/Mbrojtje të Mjedisit (nr i stafit dhe kualifikimi, emërtimi, organizimi i brendshëm, konflikt mandati për planifikim/lëshim të lejeve)**

Kryesuesja – sipas disa raporteve shumë drejtori komunale nuk kanë emërtimet e përbashkëta. Kërkesa jonë është të ketë një unifikim të emërtimit të drejtorive komunale në fushën e planifikimit hapësinor. Në përputhje me këtë duhet të bëhet përcaktimi i standardeve dhe kriterëve në organizimin e brendshëm të drejtorive dhe sektorëve të planifikimit hapësinor, kadastrat, ambientit etj.

Për këtë qëllim kemi vendosur formimin e një grupi punues brenda Kolegjiut për Planifikim Hapësinor i cili do të rishikojë dhe të përcaktojë se cili do të jetë modeli më i mirë dhe të dalim me një rekomandim për ministrinë. Po ashtu ky rekomandim duhet të paraqitet edhe para bordit të Kryetarëve në miratimin e tyre.

znj. Rraci - këto rekomandime apo këshilla duhet patjetër të dërgohen tek Kryetarët për aprovim sepse janë ata përgjegjës kryesor të cilët mund të ndryshojnë statutet e komunave në funksionimin e këtyre zyrave.

z. Saliu – kjo të jetë edhe një vërejtje për ndryshimin e Ligjit për Qeverisje Lokale, rreth funksionimit të drejtorive komunale.

Në vazhdim palët ranë dakord që të formohet komisioni prej 3 anëtarëve në përbërje:

z. Xhavit Sulejmani, Komuna e Vitisë (kryesues)

Përfaqësues nga Komuna e Prishtinës

Përfaqësues nga Komuna e Mitrovicës

Kryesuesja – u bëri me dije se nga një takim i mëhershëm, organizata MOBKOS nga Belgjika e cila operon në Kosovë dhe ka marrëveshje me Ministrinë e Infrastrukturës, ka shprehur interesim të punojë me të gjitha Komunat e Kosovës (përveç Komunës së Prishtinës) për krijimin e një plani për mobilitetin në fushën e transportit komunal duke përfshirë rrugët, shtigjet e këmbësorëve dhe biçiklistëve. Kjo organizatë ndan nga 50 euro për planet e përzgjedhura të cilat janë dorëzuar nga komunat.

Ndoshta do të ishte mirë që ne si Kolegjiut të kontaktojmë me këtë organizatë dhe të vendosim bashkërisht për format e avancimit të këtij projekti në të ardhmen. Nëse pajtohemi projekti në fjalë mund të bëjë një prezantim në takimin e ardhshëm të Kolegjiut.

Përkundër takimit të cilin e konsiderojmë të frytshëm për temat të cilat u diskutuan, si vërejtje serioze do ta theksoja pjesëmarrjen e Drejtorëve në takim të Kolegjiut. Prandaj rekomandojmë AKK-së që përmes Bordit të vet të ndikojë që drejtorët të marrin pjesë në takime, në të kundërtën nuk do të ketë efekt të mbajtjes së takimeve të Kolegjiut.

Rekomandimet :

- Ndryshim i pikës 2.5 të Rregullores së Punës së Kolegjiut
- Ndryshim i pikës 1.2.2 të Planit të Punës për vitin 2011
- Pjesëmarrja e z. Blerim Beshticës dhe znj. Leonora Rracit në grupet punuese relevante legjislative

- Themelimi i grupit punues të Kolegjiutit i përbërë nga përfaqësuesit e Komunave të Vitisë, Prishtinës dhe Mitrovicës, për të dhënë rekomandime rreth unifikimit të emërimit të drejtorive komunale në fushën e planifikimit hapësinor
- Bordi i AKK-së të bëjë kërkesë drejtorëve të marrin pjesë në takimet e Kolegjiutit